

tetor 2017

# gap | raport

## Qytetarët dhe vota e tyre

- Pritjet e qytetarëve dhe faktorët që ndikojnë në votën e tyre në Zgjedhjet Komunale





Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e **Institutit GAP** dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

## Përmbledhje ekzekutive

Kanë mbetur edhe pak ditë deri në zgjedhjet e gjashta lokale që mbahen në Kosovë që nga pas lufta. Fushata dhe zgjedhjet lokale mbahen vetëm pak muaj pas zgjedhjeve parlamentare të 11 qershorit. Në fillim të muajit tetor, Instituti GAP, përmes kompanive profesionale të matjes së opinionit, ka zhvilluar një anketë me qëllim të matjes së pritjeve të qytetarëve për zgjedhjet lokale. Po ashtu, përmes anketës, kemi synuar të kuptojmë motivet kryesore të votuesve, apo çfarë e determinon votën e tyre në zgjedhjet lokale të 22 tetorit.

Rezultatet e anketës tregojnë se mbi 70% e qytetarëve janë të prirur të besojnë se zgjedhjet lokale të 22 tetorit do të sjellin ndryshime pozitive për, familjet e tyre, komunitetin ku jetojnë, si dhe presin një qeverisje më të mirë në nivel lokal. Por, vetëm 7% e të anketuarve janë plotësisht të bindur se do të ndodhin ndryshime pozitive pas zgjedhjeve lokale. Rreth 56% e qytetarëve të anketuar janë shprehur se vota e tyre nuk do të ndryshoj nga ajo e zgjedhjeve parlamentare të 11 qershorit, kurse 14% kanë deklaruar se do të votojnë ndryshe më 22 tetor. Rreth 7% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk do të votojnë fare në këto zgjedhje.

Të pyetur se çka marrin për bazë kur vendosin se cilin kandidat do ta votojnë për kryetar/e komune, shumica e të anketuarve janë përgjigjur se bazohen në programin dhe premtimet e kandidatit/es, por edhe përvojën dhe edukimin e tij/saj. Rezultatet e anketës tregojnë se votuesit favorizojnë më shumë kandidatët e rinj në moshë. Gjithashtu, një pjesë e madhe e të anketuarve kanë treguar se marrin për bazë edhe afërsinë familjare apo shoqërore të kandidatit/es.

Mbi 52% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk do të votonin një kandidat/e komune nëse ai/ajo i takon një etnie tjetër. Kundërshtimi më i madh për të votuar një kandidat/e të një etnie tjetër është nga ana e votuesve burra se sa tek gratë votuese. Gjithashtu, bazuar në regjionet, kundërshtimet më të mëdha janë në regjionin e Pejës dhe Ferizajt, kurse më të voglat në regjionin e Prizrenit dhe Mitrovicës.

## Metodologjia

Pas përpilimit të pyetërsorit nga Instituti GAP, është kontraktuar kompania profesionale për matje të opinionit – UBO Consulting. Hulumtimi i opinionit publik është zhvilluar në 38 komuna të Kosovës duke përdorur metodën sasiore të hulumtimeve. Për përcaktimin e mostrës në këtë hulumtim është përdorur teknika e “mostrës së shtresuar me përzgjedhje të rastësishme”, me ç’rast popullata e përgjithshme është ndarë në grupe më të vogla që njihen si shtresa – bazuar në karakteristikat e përbashkëta të pjesëtarëve të këtyre shtresave.

Shtresimi i parë është bërë në bazë të përkatësisë etnike, ku janë krijuar tri nën-grupe të ndryshme. Shtresimi i dytë është bërë në bazë të vendbanimeve. Për secilën komunë është bërë shtrirja e mostrës në pjesët urbane dhe rurale, sipas statistikave zyrtare të ASK-se. Shtresimi i tretë është bërë në bazë të numrit të anketave të realizuara në secilin vendbanim (pikë startuese). Pikat startuese në këtë hulumtim janë përcaktuar sipas metodës së rastësisë. Hulumtimi në teren është zhvilluar nga data 14 deri më 25 Shtator 2017. Ky hulumtim ka nivel të besueshmërisë prej 95% me marzhë të gabimit +/-3%.


Në kuadër të këtij hulumtimi janë anketuar 1065 qytetarë të Kosovës, të moshës mbi 18 vjeç: shqiptarë (818), serb (150) dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera (97). Mostra më pas është peshuar, për të reflektuar strukturën etnike në Kosovë. Para se të administrohet pyetësori në teren, fillimisht është bërë testimi i pyetësorit për të identifikuar problemet logjike dhe përmbajtjesore, si dhe është zhvilluar trajnimi i anketuesve. Përzgjedhja e të anketuarve është bërë përmes këtyre tre fazave:

Në fazën e parë, anketuesi nga pika startuese ka përzgjedhur çdo të tretën shtëpi në anën e majtë të rrugës. Në rastet kur shtëpia e përzgjedhur ka qenë e pabanuar ose kur anketuesi është refuzuar, njësia e banimit është kaluar dhe ka vazhduar me qasjen e njëjtë sistematike. Në fazën e dytë, qëllimi ishte identifikimi dhe kontaktimi i kandidatit të përshtatshëm për intervistë. Për këtë fazë, UBO Consulting ka përzgjedhur anëtarin i cili ishte i moshës mbi 18 vjeç dhe që ka datëlindjen e ardhshme më së afërmi. Në fazën e tretë, gjatë përgatitjes për anketë, anketuesi ka sqaruar rëndësinë e ofrimit të përgjigjeve bazuar në bindjet personale të të anketuarit. Anketa është zhvilluar ballë për ballë me të anketuarin, pa prezencën e anëtarë të tjerë të familjes. Kontrolla e cilësisë së anketimit është përmes verifikimit (thirrjeve telefonike dhe vizitave) të 30% të anketave të realizuara. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në programin SPSS.

## **Pritjet e qytetarëve nga zgjedhjet e 22 tetorit**

Kjo pjesë prezanton pritjet e qytetarëve nga zgjedhjet lokale të 22 tetorit të këtij viti, dhe strukturën e preferencave të përgjithshme të qytetarëve në lidhje me zgjedhjen e kryetarëve të komunave dhe këshilltarëve komunal.


Rezultatet e anketës tregojnë se rreth 70% e qytetarëve kanë pritshmëri se zgjedhjet lokale të 22 tetorit do të sjellin ndryshime për ta dhe familjet e tyre. Por, vetëm 7% prej tyre janë plotësisht të bindur se do të ndodhin ndryshime pozitive në këtë aspekt. Ndërsa, rreth një e katërta e të anketuarve kanë deklaruar se ndryshimet pozitive mund të ndodhin vetëm deri në një masë të caktuar. Pjesa tjetër, afro 30%, nuk kanë pritshmëri se zgjedhjet komunale do të sjellin ndonjë ndryshim pozitiv për ta.



■ Pajtohem (40%) ■ Deri diku pajtohem (24%) ■ Nuk pajtohem (22%) ■ Aspak nuk pajtohem (7%) ■ Plotësisht pajtohem (7%)


**FIGURA 1.** ZGJEDHJET LOKALE TË 22 TETORIT DO TË SJELLIN NDRYSHIME POZITIVE PËR JU DHE FAMILJEN TUAJ?

Rezultatet e anketës tregojnë se rreth 45% e të anketuarve kanë pritshmëri që komuniteti i tyre do të përfitojë nga investimet e komunës gjatë mandatit të ri qeverisës. Por, vetëm 7% janë plotësisht të bindur se ndryshimet pozitive do të prekin komunitetin e tyre. Rreth 30% e qytetarëve të anketuar nuk kanë pritshmëri të mëdha se do të ketë ndryshime pozitive për komunitetin ku ata jetojnë. Kurse 27% kanë deklaruar se nuk presin që komuniteti i tyre do të jetë përfitoj në ndonjë mënyrë nga komuna në mandatin e ardhshëm.



**FIGURA 2.** ZGJEDHJET LOKALE TË 22 TETORIT DO TË SJELLIN NDRYSHIME POZITIVE PËR KOMUNITETIN KU JETONI?


Në pyetjen nëse zgjedhjet lokale të 22 tetorit do të sjellin një qeverisje më të mirë në komunën e tyre, rreth 45% e të anketuarve janë shprehur se janë optimistë që një gjë e tillë do të ndodhë. Edhe pse, vetëm 10% janë të bindur plotësisht se komuna e tyre do të qeveriset më mirë. Në anën tjetër, 28% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar që qeverisja e ardhshme lokale mund të jetë më e mirë deri në një masë, dhe 27% janë shprehur pesimist për një qeverisjeje më të mirë.



■ Pajtohem (35%) ■ Deri diku pajtohem (28%) ■ Nuk pajtohem (20%) ■ Plotësisht pajtohem (10%) ■ Aspak nuk pajtohem (7%)

**FIGURA 3.** ZGJEDHJET LOKALE TË 22 TETORIT DO TË SJELLIN NJË QEVERISJE MË TË MIRË NË NIVEL LOKAL?

Shumica e të anketuarve (56%) kanë deklaruar se do të votojnë njësoj si kanë votuar në zgjedhjet parlamentare të 11 qershorit të këtij viti. Kurse, 14% e votuesve kanë ndërruar mendje dhe nuk do të votojnë ashtu si kanë votuar pesë muaj më parë. Rreth 13% e të anketuarve nuk janë të vendosur së për kë do të votojnë, e 7% të tjerë kanë deklaruar se nuk do të dalin të votojnë fare.



**FIGURA 4.** VOTA PËR ZGJEDHJET PËR KRYETAR KOMUNE

Nga analizimi i mëtejshëm i përgjigjeve të anketuarve të cilët kanë deklaruar që në zgjedhjet lokale do votojnë për kandidatin që vije nga partia për të cilën kanë votuar në zgjedhjet nacionale të 11 qershorit, dallohet se shumica e tyre janë të rinjë dhe të moshës së mesme. Por, të rinjtë përbëjnë po ashtu edhe grupin më të madh të atyre që janë ende të pavendosur se si do të votojnë.


**TABELA 1.** STRUKTURA E VOTUESVE SIPAS MOSHËS

Votimi për:	Moshë					
	18-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
<b>Për partinë që keni votuar në zgjedhjet parlamentare të 11 qershorit 2017?</b>	24%	26%	21%	14%	8%	7%
<b>Për një parti tjetër nga ajo që kam votuar në zgjedhjet e 11 qershorit 2017?</b>	24%	25%	25%	13%	10%	4%
<b>Nuk do të votoj fare</b>	23%	16%	14%	22%	14%	11%
<b>Nuk kam vendosur ende</b>	33%	31%	11%	15%	9%	2%
<b>Refuzoj të përgjigjem</b>	43%	27%	18%	10%	3%	0%

## Faktorët që ndikojnë në votën e qytetarëve për kryetarin/en e komunës


Për të kuptuar se si i ndërtojnë preferencat e tyre votuesit dhe çka ndikon në votën e tyre, të anketuarit janë pyetur se cilët faktorë i marrin për bazë kur të vendosnin se cilin kandidat/e e votojnë për kryetar/e komune. Pjesa më e madhe e të anketuarve vlerësojnë programin dhe premtimet, përvojën dhe të kaluarën politike, si dhe përgatitjen shkollore të kandidatit si nga faktorët bazik që ndikojnë në vendimin e tyre. Po ashtu, ndikim të theksuar në vendimin e qytetarëve për përzgjedhjen e kandidatit/es për kryetar/e të komunës zë edhe përkatësia partiake e tij/saj. Rezultatet tregojnë se votuesit favorizojnë kandidatët e rinj në garë më shumë se sa ata më në moshë. Një numër i madh i votuesve votën e jep edhe duke u bazuar në lidhjet familjare, shoqërore dhe në vendbanimin prej nga vjen kandidati/ja për kryetar/e komune.






**FIGURA 5.** CILËT FAKTORË DO TI MERRNI PËR BAZË KUR TË VENDOSNI SE CILIN KANDIDAT/E DO TË VOTONI PËR KRYETAR TË KOMUNËS?

Pyetjes nëse do të votonin një kandidat/e për kryetar/e komune i/e cili/a nuk është i të njëjtës etni me votuesin, mbi 52% e të anketurave i janë përgjigjur me “Jo”. Nga ta, 56% janë burra, ndërsa 48% gra. Edhe pse dallimet janë të vogla, një përqindje më e madhe e grave (27%) se sa e burrave u përgjigjën janë të prirura të votojnë për një kandidat/e pjesëtar/e e një komuniteti tjetër.




**FIGURA 6.** GJASAT QË QYTETARËT TË VOTOJNË NJË KANDIDAT PËR KRYETAR KOMUNE QË NUK ËSHTË PJESËTAR I ETNISË TË TYRE.

Edhe pse në secilën grup moshë ekziston një përqindje e lartë e atyre që nuk do ta votonin një kandidat/e për kryetar komune që nuk është pjesëtar/e i etnisë së tyre, ky qëndrim është më i theksuar tek qytetarët 45-54 vjeç (62%) dhe 65+ vjeç (67%).



**FIGURA 7.** GJASAT QË QYTETARËT TË VOTOJNË NJË KANDIDAT PËR KRYETAR KOMUNE QË NUK ËSHTË PJESËTAR I ETNISË TË TYRE, SIPAS MOSHËS


Pozicionimi kundër votimit të një kandidati/e për kryetar komune që nuk është i etnisë së njëjtë sikurse votuesit është më i pranishëm tek personat që kanë përfunduar vetëm disa vite të shkollës fillore (rreth 70%). Por, edhe një përqindje e lartë e qytetarëve që kanë përfunduar studimet e doktoratës apo magistraturës mbajnë të njëjtin qëndrim (rreth 50%).



**FIGURA 8.** GJASAT QË QYTETARËT TË VOTOJNË NJË KANDIDAT PËR KRYETAR KOMUNE QË NUK ËSHTË PJESËTAR I ETNISË TË TYRE, SIPAS EDUKIMIT


Sa i përket refuzimit të kandidatëve për kryetarë komunash të një etnie tjetër, të anketuarit në regjionin e Pejës (77%), Ferizajt (75%), Gjilanit (68%) dhe

Prishtinës (61%) janë treguar më kategorikë se ata të regjionit të Prizrenit (30%), Gjakovës (33%) dhe Mitrovicës (35%).



**FIGURA 9.** GJASAT QË QYTETARËT TË VOTOJNË NJË KANDIDAT PËR KRYETAR TË KOMUNËS QË NUK ËSHTË PJESËTAR I ETNISË TË TYRE, SIPAS REGJIONIT


Nëse analizojmë shpërndarjen e të anketuarve sipas përkatësisë etnike në raport me pozicionimin që kanë kundrejt një kandidati/e për kryetar komune me përkatësi etnike tjetër, të dhënat tregojnë se të anketuarit me përkatësi etnike Boshnjake (83%), Shqiptare (53%) dhe Serbe (43%) janë më refuzues. Më të hapurit në këtë aspekt janë të anketuarit me përkatësi Egjiptiane (86%), Rome (75%) dhe Gorane (75%).



**FIGURA 10.** GJASAT QË QYTETARËT TË VOTOJNË NJË KANDIDAT PËR KRYETAR KOMUNE QË NUK ËSHTË PJESËTAR I ETNISË TË TYRE, SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE


## Faktorët që ndikojnë në votën e qytetarëve për anëtarët e Kuvendit Komunal

Përgjigje të ngjashme si për kandidatët për kryetar të komunës, respondentët dhanë edhe kur u pyetën rreth faktorëve në të cilët bazohen kur vendosin të votojnë për një kandidat/e për kuvendin komunal. Specifikisht, programi, përgatitja shkollore, përvoja politike dhe përkatësia partiake e kandidatit ishin faktorët më me ndikimin në vendimin e respondentëve së për kë të votojnë për kuvendin komunal.




**FIGURA 11.** CILËT FAKTORË DO TI MERRNI PËR BAZË KUR TË VENDOSNI SE CILIN KANDIDAT PËR KUVEND KOMUNAL DO TA VOTONI?

Ngjashëm, si për kandidatët/et për kryetar/e komune, shumica e të anketuarve (53%) janë shprehur kundër dhënies së mundësisë një kandidati/e që garon për kuvend komunal por që është i një etnie tjetër nga ajo e tyre.




**FIGURA 12.** GJASAT QË QYTETARËT TË VOTOJNË NJË KANDIDAT POTENCIAL PËR KUVEND KOMUNAL QË NUK ËSHTË PJESËTAR I ETNISË TË TYRE, SIPAS GJINISË

Më të pozicionuar kundër idesë që ti jepet rasti një kandidati/e për kuvend komunal të etnisë tjetër përmes votës ishin të anketuarit e moshës 45-54 vjeç (60%) dhe 65+ vjeç (68%).




**FIGURA 13.** GJASAT QË QYTETARËT TË VOTOJNË NJË KANDIDAT POTENCIAL PËR KUVEND KOMUNAL QË NUK ËSHTË PJESËTAR I ETNISË TË TYRE, SIPAS MOSHËS

Nëse analizojmë shkallën e refuzimit për të votuar kandidatet për kuvend komunal për shkak se janë të një etnie tjetër, dallojmë se kategoria më refuzuese është ajo e qytetarëve me më pak vite shkollimi (65%). Por, shkallë e lartë e refuzimit është evidente në të gjitha kategoritë e edukimit.




**FIGURA 14.** GJASAT QË QYTETARËT TË VOTOJNË NJË KANDIDAT POTENCIAL PËR KUVEND KOMUNAL QË NUK ËSHTË PJESËTAR I ETNISË SË TYRE, SIPAS EDUKIMIT

Të anketuarit në regjionin e Pejës, Ferizajt, Gjilanit dhe Prishtinës kanë qenë më kategorik për të mos e votuar një kandidat/e për kuvend komunal të etnisë tjetër. Kurse të anketuarit në regjionin e Mitrovicës, Prizrenit, Gjilanit dhe Gjakovës janë treguar edhe më refuzues ndaj kandidatëve potencial për kuvend komunal se për ata për kryetarë komunash.



**FIGURA 15.** GJASAT QË QYTETARËT TË VOTOJNË NJË KANDIDAT POTENCIAL PËR KUVEND KOMUNAL QË NUK ËSHTË PJESËTAR I ETNISË SË TYRE, SIPAS REGJIONIT

Thuajse ngjashëm si për kryetar komune, të anketuarit me përkatësi etnike Boshnjake (67%), Serbe (54%) dhe Shqiptare (49%) ishin grupet më në numër që kundërshtuan idenë që të votojnë për një kandidat/e për kuvend komunal që nuk është pjesëtar i etnisë së tyre. Por, shkalla e refuzimit për kandidatët për kuvend komunal është më e vogël se për kandidatët/et për kryetar/e komunash. Kurse, të anketuarit e përkatësisë Gorane dalin të jenë më shumë më refuzues ndaj kandidatëve të etnive tjera për kuvend (63%), se për ata për kryetar/e komunash (25%). Ndërsa, Egjiptianët (86%) dhe Romët (75%) mbesin grupet më të hapura edhe ndaj kandidatëve potencial për kuvend komunal.



**FIGURA 16.** GJASAT QË QYTETARËT TË VOTOJNË NJË KANDIDAT POTENCIAL PËR KUVEND KOMUNAL QË NUK ËSHTË PJESËTAR I ETNISË TË TYRE, SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE

## Përfundim

Qëllimi i këtij raporti është identifikimi i pritjeve të qytetarëve për zgjedhjet lokale të 22 tetorit 2017, si dhe identifikimi i faktorëve se çka e ndikon votën e qytetarëve. Qëllimi i anketës nuk ka qenë identifikimi i prirjeve të qytetarëve se për cilin subjekt politik do të votojnë.

Rezultatet e anketës tregojnë se shumica e qytetarëve nuk kanë besim të plotë se zgjedhjet do të sjellin ndryshime pozitive, si në rrafshin personal, ashtu edhe në qeverisjen e gjithmbarshme të komunës. Qëndrimet e të anketuarve se do të votojnë njësoj si më 11 qershor, mund të sjellin ndryshime partiake në pushtetin lokal. Përkundër asaj se periudha kohore mes zgjedhjeve parlamentare dhe këtyre lokale është shumë e shkurtër, është inkurajues fakti se vetëm një përqindje e vogël e qytetarëve (7%) kanë deklaruar se nuk do të votojnë fare.

Për qytetarët, programet dhe premtimet e kandidatëve kanë shumë më shumë rëndësi se gjithçka tjetër. Por, njëkohësisht, qytetarët preferojnë të votojnë për dikë që ka nivel më të lartë të shkollimit. Gjithashtu, votuesit preferojnë të votojnë kandidatët më të ri në moshë.

Të gjeturat më interesante janë ato lidhur me qëndrimin e qytetarëve sa i përket votimit të një kandidati i cili nuk i përket etnisë së tyre. Në përgjithësi, votuesit nuk preferojnë të votojnë dikë nga etnitë tjera, pa marr parasysh përgatitjen e tij/saj. Qytetarët e anketuar, të cilët kanë më shumë kontakte me pjesëtar të komuniteteve tjera, siç janë Prizreni dhe Mitrovica, janë më të prirur të votojnë për kandidatët e etnive tjera. Gjithashtu, Boshnjakët, Serbët dhe Shqiptarët janë më refuzues ndaj kandidatëve të etnive tjera, se sa Egjiptianët, Romët apo Goranët.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

#### Instituti GAP mbështetet nga:



#### Ky projekt është mbështetur nga:



Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e **Institutit GAP** dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.